

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"S'e diskutojmë standardin që kemi fituar"/ Gjyqtari Engert Pëllumbi: Projektligji i PS, tallje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese
ADRESA	https://dosja.al/politike/projektligji-i-ps-tallje-me-vendimin-e-gjykates-kushtetuese-gjyqtari-en-i514283
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 15:23:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 15:19:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2b369965027738e7625b9e5632e3febd332f1a406bdae3d91d709cfefb4d535c1
TEKSTI	b18d3f1a90bf9c62c179f67ea3c419b501f0767e783da8c9012d67d173934092
PAMJA	aaa653f5fc28804fce7794489587401349a17ebd791e32daac2df07b722a3318

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	826d037955e08812495ed87007393e3cef64b8d5e37e49191c0e9fad8fa617ff
E MËPARSHMJA	66aa6d3ad7590ff653f1f4c1696459938d7d6435d7d5dff9b1422bd242857b75
RRËNJA MERKLE	732ea03e09e76f3f4c4f7148212f99ed57cacfcbea6b7c5016ac103a159e81ab
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/826d037955e08812495ed87007393e3cef64b8d5e37e49191c0e9fad8fa617ff>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

18 MINUTA ME PARË

SHBA fokus te kartelet e drogës, zv/ndihmës Sekretari i Shtetit: Po punojmë për shkatërruar organizatat kriminale transnacionale në Shqipëri. Kosovë- Serbi të shmangin provokimet

2 ORE ME PARË

Pagat e magistratëve/ Seanca dëgjimore me institucionet e drejtësisë në komisionin e Ligjeve, KLP e GJL kundër formulës së PS: Rritje minimale

6 ORE ME PARË

Rekursi i Veliajt në Gjykatën e Lartë/ GJL lë fuqi vendimin e GJKKO-së, Erion Veliaj mbetet në burg

21 ORE ME PARË

107 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

Politike

"S'e diskutojmë standardin që kemi fituar"/ Gjyqtari Engert Pëllumbi: Projektligji i PS, tallje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese

Ai theksoi se formula e propozuar nga Partia Socialiste është larg asaj të vendosur nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj. Gjyqtari i Apelit të GJKKO theksoi se formula e re ka hyrë në fuqi dhe është një standard që e kanë fituar, me të cilin nuk do të negociojnë.



15 Shtator 2026, 17:19
Nga E. D



Engert Pëllumbi

TIRANË- Kryetari i Shoqatës së Gjyqtarëve dhe gjyqtar në Apelin e Gjykatës së Posaçme, Engert Pëllumbi ka kundërshtuar projektligjin e PS-së për pagat e magistratëve. Gjatë fjalës së tij në Komisionin e Ligjeve, Pëllumbi ka thënë se projektligji i PS-së jo vetëm që nuk e respekton vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por është edhe një tallje për të.

Ai theksoi se formula e propozuar nga Partia Socialiste është larg asaj të vendosur nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj. Gjyqtari i Apelit të GJKKO theksoi se formula e re ka hyrë në fuqi dhe është një standard që e kanë fituar, me të cilin nuk do të negociojnë.

PJESE NGA FJALA E GJYQTARIT NE KOMISIONIN E LIGJEVE:

GJK si kurrë më parë ka folur qartë prerë e saktë dhe nuk ka lënë vend për interpretim. Projekti konkret, jo vetëm që nuk e respekton vendimin 15/2026 të GJK, por do ta konsideroja si një tallje me këtë vendim dhe me të drejtën e magistratëve për të marrë një pagë dinjitoze, sikurse standardet e kushtetutës, neni 138, e përcaktojnë. GJK, në vendimin e saj, ishte e qartë. Nuk e la tërësisht në diskrecionin e Kuvendit. Sigurisht që Kuvendi ka diskrecion. Por ashtu sikurse një organ i administratës publike diskrecionin e ushtron në përputhje me ligjin. Edhe Kuvendi i Shqipërisë diskrecionin e ushtron në përputhje me Kushtetutën. Me kushtetutë, do të kuptojmë atë që GJK interpreton. Vendimet e GJK kanë fuqinë e ligjit, por për mua janë më shumë se kaq.

Janë pjesë e pandarë e Kushtetutës. Ashtu sikurse vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut përbëjnë atë çfarë ne kuptojmë me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. GJK vendosi disa kritere se ku duhej të bazohej Kuvendi me bëjten e formulës së re. Pra të marrë parasysh indeksin e çmimeve, rritjen ekonomike, rritjen e

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 15 SHTATOR 2026, 13:44

Skema se si IUTE zbras
fitimin nga Shqipëria, që ju
merr konsumatorëve me
interesa mbi 30%!

POLITIKE 15 SHTATOR 2026, 13:00

"Paga bruto e një magjistari"/
Gafat e njëpasnjëshme të
deputetes socialiste: Mos e
bëni kaq të madhe, është laps

pagave në sektorin publik, të gjitha. Dhe në rast se Kuvendi nuk do ta kishte të qartë se sa bëjnë të gjitha këto rritje, ajo përcaktoi vetë një formulë dhe tha se nëse Kuvendi nuk vepron deri më 31.07.2026, atëherë paga referuese do të jetë ajo e përcaktuar në vendimin e saj pararendës, që është vendimi 35 i vitit 2022. Referencë është paga e drejtorit të departamentit në Këshillin e Ministrave, kategoria e parë, Klasa e Dytë, që sot i bie në 236 425 lekë. Argumentet tona përforcohen si pasojë e mosveprimit të Kuvendit.

Në datën 1 gusht, formula ka hyrë në fuqi. De jure ne e kemi sot një pagë referuese. Është kthyer edhe de facto, se ka marrë Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, është ekzekutuar sigurimi i padisë. Është ekzekutuar edhe Gjykata e Durrësit. Pra ne sot po flasim me një pagë referuese, reale konkrete, e cila është 236 425 lekë. Ku qëndron diskrecioni i Kuvendit? Në dy momente. Momenti i parë është të përcaktojë formulën për të arritur minimalisht të kjo vlerë. Nëse më pyesni personalisht, do të preferoja referencën të nëpunësi civil, atë që bënë partnerët ndërkombëtarë. Unë po them një mendim personal. Ata kanë më shumë eksperiencë sesa ne dhe duke ditur se kategoria më vulnerabël dhe të cilës i reflektohen më shpejt ndryshimet ekonomike, preferuan se referencën e pagave të magistratëve ta bënin tek nëpunësit civilë se janë ushtri e tërë me 100 e ca mijë civil dhe janë një shtresë e rëndësishme për vendin.

Çdo qeveri priret t'i mbajë me paga të tilla që të përballojnë kushtet e jetesës. Kështu që formula e sjellë në këtë projekt është shumë larg asaj formule që ka hyrë në fuqi. Ajo që na mbetet të diskutojmë se si të shkojmë te kjo formulë. Nuk mund të diskutojmë standardin që tashmë ne e konsiderojmë se e kemi fituar. Sa i përket pjesës tjetër të shtesës së Gjykatës së Lartë. Unë nuk e konsideroj të drejtë që GJL t'i konsiderohet vështirësi natyra e punës që bën ajo, duke qenë se shkallët e para dhe Apelet pa patur ndihmës përballojnë një punë më të madhe se GJL dhe Gjykata e Posaçme, këtë shtesë e merr për dy arsye. E para për kufizimet që ka në jetën private, ku parashikohet monitorimi i telefonit, email, i llogarive bankare dhe e dyta, për shkak të natyrës së çështjeve që gjykon, korrupsioni në nivele të larta dhe krimi i organizuar. Gjykata e Lartë mbetet gjykatë ligji, nuk i gjykon këto çështje në themel.

Dhe e dyta, gjyqtarët e GJL nuk e kanë kufizimin e privatësisë që kanë gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme, që janë gjyqtarët e shkallës së parë dhe Apelit, Prokuroria e Posaçme dhe BKH. Pra, edhe pse GJL, mund t'i gjykojë këto çështje, i gjykon në pikëpamje të ligjit. A duhet të ketë diferencë më të madhe midis shkallëve të Apelit dhe GJL? Patjetër. Mendoj se 8 përqind është pak. Mund të marrim shembuj plot. Italia i jep më shumë peshë vjetërsisë sesa shkallëve. Gjermania më shumë peshë shkallëve sesa vjetërsisë. Ne zgjodhëm formulë 8%. Mund të ndreqet. Mund të bëhet 10, 20. Këtu Kuvendi ka diskrecion të plotë, pa e ulur më pak se 8% se është standard i fituar. Sa i përket barrës fiskale, mund të negociohet shpërndarja e kësaj barre në disa vite, është propozuar në dy, mund të bëhet në 3, 4. Mund të negociohet dhe këtu mund të ketë tolerancë.

Miratimi i një ligji që do të respektonte standardin e vendimit të GJK do të bënte që të gjithë magistratët të tërhiqnin paditë. Kanë disa kosto nga pas. Nuk është vetëm vlera e pagës që magistrati duhet të marrë. Është vlera e shpenzimeve të avokatit, përmbaruesit, ekspertit. Dhe këto janë kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Për të lehtësuar barrën fiskale mundet të ndahen funksionarët që referencën e kanë te paga e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nuk janë pak. Kjo do të ulte barrën fiskale. Nuk flitet për barrë fiskale, kur flasim për standarde. Kjo është gjë që nuk e kemi pushtetin ta negociojmë. Nuk negociohet me Kushtetutën, nenit 138, 132 dhe vendimet e GJK.

Sa i përket barazisë në pagave në GJL, është e vetmja pikë e këtij projektligji për t'u përhëndetur. Duhet të vendosur një barazi ndërmjet pagës së gjyqtarëve të GJL me gjyqtarët e karrierës. Projektligji parashikonte se vjetërsia jashtë sistemit gjyqësor të njihet si vjetërsi për efekt të llogaritjes së pagës në GJL. Pra nëse një profesor ka 25 vite që jep mësim në universitet, duhet t'i llogaritet paga maksimale vjetërsi.**[Dosja.al]**

engert pëllumbi

Sondazh

Poll

ART&ARGËTIM 15 SHTATOR 2026, 10:17

Matthew Rhys bën histori në Emmy Awards, bëhet aktori i parë që fiton dy çmime kryesore në një natë

më të klikuarat



Pse bën foto? Rama kap të riun nga qafa dhe ia dorëzon policisë, çfarë ndodhi në Aeroportin e Napolit? (VIDEO)

Vrasja e Franc Konomit, flasin familjarët e tij/ Gruaja: Hotelin ia mori vëllai dhe ia shiti. I biri: Kanë dashur të më vrasin edhe mua dy herë

Dhunuan me grusht qytetarin gjatë arrestimit, Taulant Balla i del në mbrojtje Policisë: Bën detyrën e tyre

Vitin e ardhshëm zgjedhjet lokale/ Qeveria 'hap thesin' për pensionistët: Nga 1 janari do dyfishohet bonusi për të gjitha kategoritë

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by tomorrow

Politike

15 Shtator 2026, 17:10

"KFOR me rëndësi për stabilitetin në Ballkan"/ Daniel Lawton: Administrata e Trump po angazhohet në nivele të larta! Do donim të shihnim më shumë progres në...

Daniel Lawton TIRANË- Zëvendësndihmës Sekretari amerikan i Shtetit, Daniel Lawton, deklaroi se bashkëpunimi me Ballkanin Perë...

Pagat e magjistratëve/ Komisioni i
Ligjeve miraton draftin e PS me 8 vota
pro dhe 3 kundër të opozitës

Politike

15 Shtator 2026, 16:57

Daniel Lawton: Po punojmë për të goditur
në Shqipëri organizatat kriminale
transnacionale

Politike

15 Shtator 2026, 16:38

"Kosova dhe Serbia të shmangin
provokimet"/ Zv/Ndihmës Sekretari i
Shtetit, Daniel Lawton: Angazhimi me
Ballkanin përëndimor matet me rezultate
të dukshme

Politike

15 Shtator 2026, 16:30

Nisin punimet për ndërtimin e bypassit
të Elbasanit/ Karakaçi: Autostradë e
kategorisë A, do i japë zgjidhje të
qëndrueshme problematikës së trafikut
në zonë

Politike

15 Shtator 2026, 16:28

Politike

15 Shtator 2020, 15:33

Ngërçi politik në Kosovë/ LVV e LDK pezullojnë bisedimet për presidentin

Kreu i LDK-së, Lumir Abdixhiku, së bashku me ish-presidenten, Vjosa Osmani, gjatë takimit me kreun e LVV-së, Albin Kurti, dhe zyrtarin e l...

Gjykata e Lartë e la në burg Erion Veliajn/ Rama: Sërish Tirana pa kokë, askush nuk do t'ia dijë për koston e kryeqytetit

Politike

15 Shtator 2020, 15:20

SHBA fokus te kartelet e drogës, zv/ndihmës Sekretari i Shtetit: Organizatat kriminale kërcënojnë edhe SHBA. Ngërçi politik në Kosovë problem

Politike

15 Shtator 2020, 14:55

Pagat e magjistratëve/ Zv.kryetari i GJL kundër formulës së PS: Nuk e realizon standardin e vendosur nga Kushtetuesja

Politike


15 Shtator 2020, 14:55





Pagat e magjistratëve/ Kryetarja e KLP-së kundër draftit të PS: Rritje minimale, nuk reflekton standardin e Kushtetueses

Politike

15 Shtator 2020, 14:10

MË SHUMË





Daja i deputetes Zegjine
Çausi plagosi ish-vjehrrin
me drapër, rrëfëhet partnerja:
Më ka dhunuar...

Korreshi përplasur me Gogun për Sokol Sadushin, ministri: Nuk e ke kuptuar ende punën e një deputeti

 Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE 

Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk
ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i
pavarsur dhe aftësia e analizimit të faktit janë në qendër të punës së dosja.al

AKTUALITET

Drejtor: Enton Abilekaj

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.